




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Plani i Veprimit për Harmonizim në Shqipëri

PREZANTUAR
tek Tryeza e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë
më 13 Nëntor 2009

Nëntor 2009





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

Plani i Veprimit për Harmonizim në Shqipëri

Prezantuar
tek Tryeza e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë
më 13 nëntor 2009

Nëntor 2009

Pasqyra e lëndës

	Shkurtime.....	3
I.	Indikatori 1: Strategjitë Operacionale të Zhvillimit.....	7
II.	Indikatori 2: Sistemet e Besueshme të Vendit	11
III.	Indikatori 3: Flukset e Ndhmës të përafuara me Prioritete Kombëtare.....	15
IV.	Indikatori 4: Forcimi i kapaciteteve me mbështetje të koordinuar	18
V.	Indikatori 5: Përdorimi i Sistemeve MFP dhe të Prokurimit	21
VI.	Indikatori 6: Forcimi i kapaciteteve duke shmangur strukturat zbatuese paralele.....	24
VII.	Indikatori 7: Ndhmë më e parashikueshme	26
VIII.	Indikatori 8: Ndhma e pakushtëzuar	29
IX.	Indikatori 9: Përdorimi i rregullave apo procedurave të përbashkëta.....	30
X.	Indikatori 10: Inkurajimi i analizës së përbashkët	33
XI.	Indikatori 11: Menaxhim për Rezultate	35
XII.	Indikatori 12: Llogaridhënia e Ndërsjellë.....	39
XIII.	Plani i Veprimit – Hapat që duhen ndjekur	41

Shkurtime

KM	Këshilli i Ministrave
CARDS	Ndihma Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CEB	Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës
CPIA	Vlerësimi Institucional dhe i Politikave të Vendit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj
STD	Sekretariati Teknik i Donatorëve
SMINH	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Ndihmën e Huaj
DONH	Dokumenti i Orientimit të Ndihmës së Huaj
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
BE	Bashkimi Evropian
QSH	Qeveria e Shqipërisë
PVH	Plani i Veprimit për Harmonizim
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrument i Asistencës së Para-anëtarësimit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
MIE	Ministria e Integritit Evropian
MF	Ministria e Financës
PIM	Planet e Integruara të Ministrisë
MIPD	Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar
FSHB	Fondi Shumëpalësh i Besimit
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
NjZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
APP	Agjencia e Prokurimeve Publike
RPP	Rishikimi i Politikave Prioritare
ODA	Ndihma Zyrtare e Zhvillimit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OECD/DAC	Komiteti i OECD për Zhvillimin e Ndihmës
PBP	Përfaqse me Bazë Programi
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
PBS	Përfaqse me Bazë Sektoriale
GSP	Grupi Sektorial i Punës
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNPCDC	Qendra për Zhvillimin e Kapaciteteve të Prokurimit e OKB-së
BB	Banka Botërore

Vështrim i përgjithshëm

Pas Konsensusit të Monterrejt për Financimin e Zhvillimit (mars 2002) dhe Deklaratës së Romës (shkurt 2003), në shumë vende në zhvillim janë përgatitur Plane Veprimi për Harmonizim (PVH). Qëllimi i këtyre planeve është që të rritin efikasitetin dhe efektshmërinë e menaxhimit të ndihmës dhe bazohen në parimet e rritjes së pronësisë, harmonizimit të përputhjes së ndihmës me politikat prioritare, duke përdorur sistemet qeveritare kur është e mundur duke harmonizuar dhe thjeshtuar procedurat e donatorëve. Këto plane merren me harmonizimin jo thjesht në kuptimin e ngushtë që presupozon miratimin e procedurave të përbashkëta dhe shpërndarjen mes donatorëve të konstatimeve analitike dhe vlerësimeve, por me një gamë të gjerë masash me fokus efikasitetin e ndihmës.

Planet e Veprimit për Harmonizim janë specifike për rrethanat e çdo vendi, por që nga Deklarata e Parisit mbi Efikasitetin e Ndihmës në mars 2005, ato bazohen në pesë angazhimet e partneritetit të shpallura në këtë Deklaratë:

- Pronësia
- Përafrimi
- Harmonizimi
- Menaxhim për Rezultate
- Llogaridhënia e Ndërsjellë

Deklarata e Parisit (Shtojca A) përcakton indikatorët dhe objektivat e miratuar në DAC që nevojiten për të miratuar zbatimin e Deklaratës së Parisit.

Ndërhyrjet për përmirësimin e efikasitetit të ndihmës varen nga rrethanat e vendit, si dhe nga mundësitë dhe prioritetet e perceptuara nga qeveria dhe donatorët. Për këtë arsye, përgatitja e PHV-së orientohet nga dy udhëzimeve të rëndësishme:

- i. Që PVH të jetë udhërrëfyese efikas dhe i zbatueshëm, ai fillon me një analizë të pengesave që duhen adresuar për të përmirësuar efikasitetin e ndihmës, pastaj përcakton hapat që duhet të marrin donatorët dhe qeveria gjatë periudhës që shtrihet plani;
- ii. Që donatorët dhe qeveria të jenë plotësisht të angazhuar në realizimin e veprimeve, procesi i përgatitjes së planit konsiderohet po aq i rëndësishëm sa vetë përmbajtja e dokumentit përfundimtar. Të gjitha palët duhet ta kenë të qartë jo vetëm nevojën për të bërë një PVH, por edhe implikimet që PVH sjell në procedurat e tyre të brendshme dhe praktikën e punës, dhe të jenë të gatshëm (dhe të kenë autoritetin) për të bërë ndryshimet e kërkuara.

Kështu, përgatitja e planit ishte një proces negociatash mes partnerëve të zhvillimit, të përfaqësuar nga Sekretari Teknik i Donatorëve (STD) dhe qeverisë, e përfaqësuar nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON), në lidhje me parimet dhe politikën e sakta që duhen përdorur si bazë për PVH-në dhe zbatimin e tij. Vendimtar për efikasitetin e planit është angazhim i qeverisë dhe i donatorëve për çfarë është rënë dakord.

Deklarata e Parisit dhe Axhenda e Akrës për Veprim, edhe pse ofrojnë një kuadër analitik të shëndetshëm dhe të dobishëm që përcakton të dy fushat ku nevojitet veprim global për të përmirësuar efikasitetin e ndihmës dhe mënyrat se si vlerësohet progresi,

nuk thonë asnjë gjë se çfarë masash nevojiten për të sjellë ndryshime në këto drejtime. Kjo mund të arrihet vetëm me axhendë individuale për çdo shtet. Plani i veprimit efikas duhet të jetë konkret dhe me detyra të qarta, në mënyrë që individët të ngarkohen për t'i realizuar brenda një afati, si edhe për të evidentuar aktivitetin që shkon kundër planit (përveç monitorimit të rezultateve në nivel kombëtar që diskutohen më poshtë). Këto detyra duhet të përcaktohen sipas realiteteve specifike të një shteti, sipas projekteve dhe programeve aktuale ku donatorët janë angazhuar, si edhe kushteve të sistemeve të qeverisjes (p.sh. për planifikimin kombëtar, menaxhimin financiar publik apo prokurimin).

Për këto arsye, një PVH efikase për Shqipërinë duhet të ketë një analizë të plotë të pozitës aktuale, në kuptimin e parimeve të Deklaratës së Parisit, ku të qartësohet deri në çfarë shkalle janë arritur pronësia, përafrimi, harmonizimi, orientimi drejt rezultateve dhe llogaridhënia e ndërsjellë, si edhe faktorët që pengojnë progresin e mëtejshëm në këto drejtime.

Plani i Veprimit për Harmonizim i Shqipërisë duhet të përmbajë dy elemente:

- i. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet donatorëve dhe Qeverisë së Shqipërisë (QSH), që miraton PVH-në, përcakton parimet e Planit, monitorimin dhe çështjet e tjera themelore;
- ii. Program Veprimi, brenda kuadrit të temave kyçe dhe angazhimeve të Deklaratës së Parisit, që përcakton veprime praktike që nënshkruarit duhet të ndërmarin në tre vitet në vazhdim për të arritur përmirësime reale në efikasitetin e ndihmës. Plani do të përmirësohet çdo vit nën dritën e zhvillimeve, sidomos të sistemeve të Qeverisë.

Monitorimi

1. Sistemi i monitorimit do të jetë pjesë e pandarë e PVH-së, bashkë me një proces menaxhimi të programit që mundëson ndjekjen e aktiviteteve të çdo komponenti të Programit, si dhe parametrat që shërbejnë për të vlerësuar progresin. Meqë PVH bazohet në parimet e Deklaratës së Parisit, monitorimi i progresit në zbatimin e Programit të Veprimit duhet të lehtësojë monitorimin dhe raportimin e progresit nën sitën e 12 indikatorëve të përcaktuar në Deklaratë ("Indikatorët e Parisit"). Në praktikë, monitorimi ndërkombëtar që ndjek OECD/DAC lejon hapësirë më të madhe interpretimi të indikatorëve në nivel vendi, por do të jetë e rëndësishme që të dhënat e mbledhura për zbatimin e PVH-së, të jenë të tilla që të mund të përdoren për t'ia raportuar DAC-it, me qëllim që të shmangen sisteme të shumëfishta regjistrimi dhe raportimi.
2. Vlerat e objektivave afatshkurtër dhe afatgjatë u miratuan në diskutimet mes STD-së dhe DEBASKON-it. Projekt-dokumenti është konsultuar me komunitetin e gjerë donator gjatë periudhës maj-shtator 2009. Komentet e tyre u pasqyruan në PVH përfundimtare.

Indikatorët 1-12 të Deklaratës së Parisit
Situata aktuale dhe rekomandime për masat dhe hapat që duhen ndërmarrë me
qëllim që të arrihen objektivat e 2010-ës

I. Indikatori 1: Strategjitë Operacionale të Zhvillimit

Indikatori 1: Strategjitë Operacionale të Zhvillimit	
Objektivi global 2010	Të paktën 75% e vendeve partnere të kenë strategji operacionale zhvillimi
Objektivi në nivel vendi 2010	Klasifikim "B" ose "A"
Klasifikimi 2005	C
Klasifikimi 2007	C
Dimensioni	Pronësia

1. *Përkufizim:* Numri i vendeve me strategji operacionale zhvillimi (përfshi Strategjitë për Uljen e Varfërisë) që kanë prioritet strategjike të qarta të lidhura me kuadrin e shpenzimeve afatmesme dhe të pasqyruara në buxhete vjetore.

Indikatori evidenton kryesisht nëse vendi ka strategji operacionale zhvillimi që donatorët t'i përdorin për harmonizimin e asistencës. Vetë strategjia operacionale e zhvillimit duhet të ketë këto katër elemente: (i) të jetë e prioritetuar; (ii) të jetë e orientuar drejt rezultateve; (iii) të hartohet me vizion afatgjatë; dhe (iv) të formësojë shpenzimet publike të vendit.

2. Matja e këtij Indikatori

Indikatori 1 matet nga Banka Botërore nëpërmjet një shqyrtimi, jo nëpërmjet pyetësorëve që përdoren për shumicën e indikatorëve. Për vlerësimin sasior të kritereve është përdorur metodologjia LEADS¹.

Për të vlerësuar nëse një vend ka strategji operacionale zhvillimi, përdoren tre kritere dhe një shkallë me 5 pikë:

- *Kuadër strategjik të unifikuar:* vendi ka vizion afatgjatë koherent me një strategji afatmesme që rrjedh nga ky vizion dhe e cila lidhet me strategjitë e zhvillimit sektorial apo vendor.
- *Prioritizimi:* vendi ka objektiva zhvillimi të lidhura me rezultate afatgjata holistike dhe të balancuara. Veprimet afatmesme të evidentuara në strategjinë kombëtare të zhvillimit lidhen me këto rezultate dhe janë të sinkronizuara.
- *Lidhje strategjike me buxhetin:* vendi zotëron burimet dhe kapacitetet fiskale për të bërë strategjinë të funksionojë, përfshi inkorporimin e të dhënave nga *feedback-u* në rishikimet e strategjisë dhe të buxhetit.

3. Rezultatet e Anketës 2008²

Anketa 2008 filloi më 2 janar dhe përfundoi më 31 mars 2008. Të dhënat u grumbulluan gjatë këtyre tre muajve dhe në analizë janë përfshirë të dhënat e

¹ Metodologjia LEADS është akronim dhe secila gërmë përfaqëson rendin e shkallës së matjes. Konkretisht, L përfaqëson "veprim i pakët"; E përfaqëson "elementët ekzistojnë"; A përfaqëson "veprim i ndërmarrë"; D përfaqëson "i zhvilluar"; dhe S përfaqëson "i qëndrueshëm";

² Edhe pse pyetësorët donatorë/qeveri nuk u përdorën për matjen e këtij indikatori, vlerësimi i përgatitur nga Banka Botërore është përfshirë në Kapitujt e Vendit të Rezultateve të Anketës 2008. Për këtë arsye, e kemi përfshi nën këtë kre.

siguruara gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2007. Projekt raporti u finalizua në maj 2008. Për matjen e indikatorit 1, është përdorur "Strategjitë Kombëtare për Zhvillim bazuar në Rezultate: Vlerësimet dhe Sfidat e Pritshme", e përgatitur nga Banka Botërore në dhjetor 2007. Shqipëria mori notën C nga Anketa 2006 dhe 2008; raporti i anketës 2008 njih njëfarë progresi në këtë indikator, por që nuk mjafton për të përmirësuar notën e vendit. Megjithatë, duhet thënë se anketa 2008 u bazua ndjeshëm në vlerësimin 2006 të bërë nga Banka Botërore, kështu që nuk pasqyron plotësisht të gjithë progresin e bërë gjatë 2006-2007.

Në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) që hap rrugën drejt anëtarësimit në BE. Ky vizion afatgjatë është mishëruar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)³, dhe mundëson bashkërendimin efektiv të politikave të BE-së me prioritetet specifike për zhvillimin e vendit. Po bëhen përpjekje të konsiderueshme për të lidhur SKZHI me buxhetin, kryesisht nëpërmjet Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Gjithashtu, Shqipëria ka filluar të zbatojë Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI) që në vitin 2005, që përcakton disa parime operuese që mundësojnë planifikimin dhe zbatimin e politikave dhe buxhetit në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar. SPI shoqërohet me një Fond Shumëpalësh Besimi (FBM) që po përdoret për të financuar forcimin e kapaciteteve për zbatimin e SPI-së në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 u përgatit deri në fund të vitit 2007, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe u miratuan pesë strategji sektoriale dhe tetë strategji ndërsektoriale.

4. *Progresi deri më sot*

SKZHI tani mbështetet nga 30 strategji sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara. Përveç strategjive të miratuara, janë në proces 6 strategji sektoriale e 2 ndërsektoriale.

Numri në rritje i strategjive që hartohen dhe miratohen, tregon se Shqipëria po ecën drejt arritjes së objektivit 2010 për këtë indikator. Por ka vend për përmirësime në mënyrën se si strategjitë shndërrohen në plane veprimi dhe në buxhet. Aktualisht, dy procese kryesore i shërbejnë këtij qëllimi: (i) Rishikimi i Politikave Prioritare (RPP) dhe PBA; dhe (ii) Planet e Integruara të Ministrisë (PIM). Këto procese kanë njëfarë kohe që funksionojnë, megjithatë, vetëm në dy vitet e fundit janë bërë më gjithëpërfshirës, duke dëshmuar një hov cilësor krahasuar me vitet e kaluara. Sidoqoftë, ka vend për përmirësime në mekanizmat e koordinimit, me qëllim që të shmangen mbivendosjet apo mungesa e konsistencës, si edhe që të rritet koherenca e investimeve të realizuara nga qeveria. Ndërkohë që është përgjegjësia e çdo Ministrie Linje që të përgatisë PBA-në dhe PIM-et e veta, DEBASKON-i ka përgjegjësi që në bashkëpunim me Ministrinë e Financës (MF) të punojë për të arritur zbatimin koherent të këtyre proceseve në të gjitha ministrinë. Në këtë kuadër, një nga veprimet më të rëndësishme të ndërmarra nga DEBASKON-i është përgatitja e përvitshme e RPP-së, e cila përfshihet në PBA dhe bëhet pjesë e pandashme e saj. Së fundmi, PBA është transformuar në një përfaqje me bazë programi, duke pasqyruar prioritetet e

³ SKZHI u miratua formalisht në mars 2008; por faza e përgatitjes dhe konsultimeve të gjera përfundoi gjatë 2007-ës.

investimeve në nivel programi. Megjithatë, kjo qëndron për investimet e brendshme dhe jo aq shumë për ndihmën e huaj. Meqë PBA është procesi vendimtar që shndërron SKZHI-në dhe strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale në terma buxhetorë, ky proces ka nevojë të forcohet vazhdimisht. Metodologjia e PBA-së tashmë është e përcaktuar dhe e njohur me ligj. Kështu, përmirësimet e procesit do të fokusohen te zbatimi nëpër ministri. Një përmirësim kyç i procesit, drejtpërdrejt i lidhur me SPI-në, është forcimi i lidhjeve midis dokumenteve kyçe strategjike (p.sh. strategjitë sektoriale, PKZMSA) dhe qëllimeve, objektivave dhe *output*-eve të politikave të programit. Kjo do t'i mundësojë qeverisë të identifikojë më saktë se si shpenzimet buxhetore po mbështesin politikat prioritare dhe të krijojë një bazë më solide për vlerësimet "të marrësh vlerën e parasë".

Edhe pse prej vitesh mbahen takime periodike midis donatorëve aktivë në një sektor dhe Ministrisë përkatëse, për shumicën e sektorëve të rëndësishëm si Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme, arsimit, transporti, etj., pikërisht brenda këtij kuadri të ri ndodhi ringjallja e Grupeve Sektoriale të Punës (GSP). Deri më sot, pjesa më e madhe e takimeve të GSP-ve janë fokusuar më shumë se si të koordinojnë më mirë ndihmën e huaj për sektorë/nëfusha specifike dhe më pak te koordinimi i politikave, monitorimi i strategjive apo investimet prioritare dhe PBA (përjashtim bëjnë disa GSP të pakta, si ato të organizuara nga International Consortium (nëpërmjet ICITAP).

5. *Rekomandime për veprime deri në fund të 2010-ës*

Rekomandimet në vijim i drejtohen qeverisë dhe komunitetit donator. Meqë indikator 1 lidhet me dimensionin e pronësisë, rekomandimet e dhëna nuk do të kufizohen vetëm te indikatorin në vetvete "*per se*", por do të mbulojnë të gjithë dimensionin e pronësisë.

Qeveria

- Për të arritur objektivat e 2010-ës, duhet që jo vetëm të miratohen strategji zhvillimi (që ekzistojnë për shumicën e sektorëve), por e rëndësishme është që këto strategji të lidhen me buxhetin dhe të përgatiten e të miratohen plane e veprime realiste. Në këtë drejtim, lidhja midis proceseve të ndryshme dhe dokumenteve orientuese duhet të forcohet (SKZHI, strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale), RPP dhe PBA, programi i investimeve, PIM). Është përgjegjësi e DEBASKON-it, MF-së dhe MIE-s që të koordinojnë këto procese ndërmjet ministrive.
- Të përgatiten lista vjetore dhe 6-mujore me programet dhe projektet prioritare, ose programime me bazë sektori për donatorët, me qëllim që të orientohen te sektorët prioritarë.
- Të institucionalizohet SPI në çdo ministri linje, me qëllimin që të rritet koordinimi mes tyre dhe DEBASKON-it. Ky i fundit duhet të rrisë presionin ndaj ministrive të linjës për të përmirësuar funksionimin dhe monitorimin e strategjive përkatëse, si edhe për përmirësimin e lidhjes ndërmjet objektivave strategjikë dhe buxhetit.

- DEBASKON-i të përgatisë vlerësime vjetore për shkallën e përfshirjes së prioritetëve strategjike në PBA dhe në buxhetin vjetor, deri në shtator 2009.
- Në 2010, prioritetet e SPI-së përfshijnë futjen e vlerësimeve për monitorimin dhe impaktin e performancës. Futja e instrumenteve të politikave si vlerësimet e impaktit, ofron një tjetër mundësi shumë të mirë për të komunikuar përpjekjet e vazhdueshme për zbatimin e suksesshëm.
- DEBASKON-i, në bashkëpunim me ministritë e linjës, të punojë për përmirësimin e zbatimit të SKZHI-së.
- Të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale që kanë hasur vonesa apo shtyrje, duhet të finalizohen dhe të miratohen brenda 3-mujorit të parë të 2010.
- Për të rritur rolin e DEBASKON-it në koordinimin e këtyre proceseve, QSH duhet të përgatitë dhe të miratojë udhëzime formale për rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve kryesore qendrore (DEBASKON, MF, MIE, etj.) në lidhje me koordinimin e donatorëve. Procedurat e Menaxhimit të Ndhmës së Huaj duhet të finalizohen brenda pranverës së 2010-ës.

Donatorët

- Donatorët të përdorin SKZHI-në, strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, PBA-në dhe DONH si dokumente kyçe për orientimin e ndihmës.
- Ndhimja donatore për këtë indikator mund të orientohet edhe në rritjen e kapaciteteve të qeverisë për të aktivizuar dhe zbatuar SKZHI-në dhe dokumentet e tjera strategjike.

II. Indikatori 2: Sistemet e Besueshme të Vendit

Indikatori 2: Sistemet e Besueshme të Vendit	
<i>Indikatori 2a:</i> Sisteme të Besueshme Menaxhimi Financiar Publik (MFP)	
<i>Indikatori 2b:</i> Sistemet e Besueshme të Prokurimit	
Objektivi global 2010	
<i>Indikatori 2a</i>	Gjysma e vendeve partnere të ngjiten të paktën një masë (dmth. 0.5 pikë) në shkallën e performancës MFP / CPIA (Vlerësimi Institucional dhe i Politikave të Vendit)
<i>Indikatori 2b</i>	Një e treta e vendeve partnere të ngjiten të paktën një masë (dmth. Nga D në C, nga C në B, ose nga B në A) në shkallën me 4 pika që përdoret për vlerësimin e performancës për këtë indikator.
Objektivi në nivel vendi 2010	
<i>Indikatori 2a</i>	4.5
<i>Indikatori 2b</i>	N/A
Klasifikimi 2005	
<i>Indikatori 2a</i>	4
<i>Indikatori 2b</i>	N/A
Klasifikimi 2007	
<i>Indikatori 2a</i>	Nuk ka
<i>Indikatori 2b</i>	N/A
Dimensioni	Përafrimi

1. *Përkufizim:* Numri i vendeve partnere që kanë sisteme menaxhimi për prokurimet dhe financat publike të cilat ose (a) aplikojnë praktika të mira të pranuar gjerësisht ose (b) kanë një program reformash për ta arritur këtë.

Më konkretisht, indikatorët 2a dhe 2b shohin nëse vendi ka sisteme të besueshme për menaxhimin publik financiar dhe prokurimet, dhe deri në çfarë mase donatorët përdorin këto sisteme për dhënien dhe menaxhimin e ndihmës.

2. *Matja e këtij Indikatori*

Për sa kohë Shqipëria ishte vend IDA, indikator 2a matej nëpërmjet CPIA-s së Bankës Botërore që bazohej në një shkallë 6-pikëshe. Që nga Anketa 2008, Shqipëria nuk konsiderohet më vend IDA, kështu që për këtë indikator nuk do të ketë vlerësim nga CPIA.

Indikator 2b: Bazuar në orientimin e OECD/DAC, duke filluar me Anketën 2008, ky indikator duhet të matet nëpërmjet Metodologjisë së OECD/DAC për Vlerësimin e Sistemeve Kombëtare të Prokurimit (Shënim Shpjegues i Anketës 2008).

Në vitin 2006, Banka Botërore në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) realizoi një vlerësim⁴ të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri në bazë të Metodologjisë së OECD/DAC të Parametrave të Përbashkët dhe Vlerësimit për Sistemet e Prokurimit Publik, që në atë kohë ishte në fazën pilot. Vlerësimi nxori në pah mangësi të theksuara në sistemin e Prokurimit Publik në Shqipëri. Megjithatë, vlerësimi u realizua në një kohë kur Qeveria e Shqipërisë ishte në procesin e

⁴ Vlerësimi përfshinte vetëm BLI dhe jo CPI.

rishikimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve publike dhe kjo mund të ketë ndikuar në rezultatet e vlerësimit. Edhe pse ky vlerësim u përfundua nga Banka Botërore në 2006, raporti përfundimtar i përgatitur nga OECD/DAC tregon që indikatorin 2b nuk është matur asnjëherë. Për këtë arsye, nuk ka vlerësim për anketën 2006 dhe 2008.

Kjo është një fushë që ka nevojë për përpjekje të konsiderueshme si nga qeveria ashtu edhe komuniteti donator, për hartimin dhe miratimin e metodologjisë për matjen e këtij indikator.

3. *Rezultatet e Anketës 2008*

Në lidhje me indikatorin 2a, pra ekzistenca e sistemeve të besueshme MFP, Shqipëria mori në 2006 vlerësimin 4.0 klasifikimi në shkallën me 6 pikë, mjaft më lart sesa mesatarja prej 3.2 pikësh për të gjitha vendet e klasifikuara nga Banka Botërore në CPIA. Meqë Shqipëria nuk është më vend IDA, mungon vlerësimi CPIA për 2007.

Në këtë sferë janë marrë një sërë masash: së pari, në vitin 2006 u krijua Departamenti i Menaxhimit të Investimeve Publike për të integruar plotësisht investimet publike, të financuara nga burime të brendshme dhe të huaja, në një proces menaxhimi të shpenzimeve publike. Për buxhetin 2008, të gjitha institucionet buxhetore dorëzuan propozimet për investimet publiku në përputhje me procedurat e reja. Përveç kësaj, për herë të parë në 2007 të gjitha Ministrinë plotësuan një proces të plotë PBA, që nga përcaktimi i kuadrit ekonomik dhe tavanëve buxhetore, deri te finalizimi i buxhetit.

Për indikatorin 2b, nuk ekziston shifër referuese për ta krahasuar (për arsyen që shpjeguam më lart); prandaj, nuk është venë objektiv në nivel vendi. Megjithatë, QSH ka marrë një sërë masash për të rritur transparencën në prokurimet publike. Në 2007, u miratua *ligji i për Prokurimet Publike*.

Ky ligj sanksionon krijimin e Avokatit të Prokurimeve Publike si organ i pavarur shqyrtues që raporton drejtpërdrejt te Parlamenti dhe që perceptohet si gur themeli në zhvillimin e prokurimeve publike në mënyrë të drejtë dhe transparente. Donatorët kanë financuar reforma të mëtejshme si për sistemin e prokurimit elektronik dhe për përmirësimin e kapaciteteve të nëpunësve të prokurimit. Sipas raportit të Bankës Botërore: *Strategjitë Kombëtare për Zhvillim Bazuar në rezultate: Vlerësim dhe Sfidat në Vijim*, zbatimi aktual i prokurimit publik shfaq probleme të konsiderueshme, sidomos në mjaft agjenci qeveritare dhe ministri që vazhdojnë praktikën e prokurimit të një burimi të vetëm, edhe pse ky pretendim nuk mbështetet nga Agjencia e Prokurimit Publik.

4. *Progresi deri më sot*

Ligji i përmirësuar për Menaxhimin e Buxhetit, u dorëzua në Parlament në fillim të 2008-ës dhe u miratua në korrik 2008. Ky ligj shërbeu për të kodifikuar PBA-në dhe si referencë për rregullimin e ndihmës së huaj. Në fakt, PBA për buxhetin 2009 ishte proces i plotë dhe shfaqti përmirësime krahasuar me buxhetin e vitit paraardhës. Ngritja dhe funksionimi i Njësisë Qendrore të Kontraktimit dhe Financimit (CFCU) në MF, pritet të rritë besimin e donatorëve në sistemet e vendit.

Gjithashtu, një dokument politikash për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik u përgatit nga Ministria e Financave me mbështetjen e projektit të CARDS 2005

"Zhvillimi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" që u përditësua në 2008. Ky dokument i përditësuar përmban disa rekomandime kyçe si të përmirësohet sistemi MFP në vend (rekomandimet janë renditur në seksionin 5 më poshtë).

Në lidhje me prokurimin, ligji për Prokurimet Publike hyri në fuqi në janar 2007 dhe u ndryshua dy herë gjatë të njëjtit vit (në shtator dhe në dhjetor). Ndryshimet në ligj vazhduan edhe në 2008, kryesisht në aktet ligjore. Për përafrimin e legjislacionit me standardet e BE-së, mbeten dy çështje madhore që duhen zgjidhur nga sistemi i prokurimit publik. Së pari, legjislacioni për prokurimet në sektorin utilitar, dhe së dyti, legjislacioni për sistemin e ankimimit brenda prokurimit publik është hartuar dhe dërguar në Parlament për miratim. Brenda sistemit të ankimimit, APP mendon të ngrejë një institucion të ri që të merret me ankesat e operatorëve ekonomikë.

APP, me ndihmën e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), po trajton në vijim të gjitha institucionet buxhetore në lidhje me prokurimin elektronik, një procedurë e re që përmirëson transparencën.

5. *Rekomandime për veprime deri në fund të 2010-ës*

Udhëheqja aktive dhe e qëndrueshme, e nxitur nga nivelet politike, është i vetmi parakusht i rëndësishëm që Përafrimi të ecë përpara përtej angazhimeve formale për ngritjen dhe përdorimin e sistemeve dhe koordinimin e nismave për forcim kapacitetesh. Rekomandimet për indikatorin 2 kanë implikime të drejtpërdrejta dhe pozitive për indikatorin 5.

Qeveria

Për të përmirësuar llogaridhënien menaxheriale, kontrollin e brendshëm, menaxhimin e riskut, shërbimet e kontabilitetit dhe monitorimin, QSH dhe veçanërisht Ministria e Financave duhet të realizojnë këto hapa:

- (2a) Të përgatitin ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK).
- (2a) Të përgatitin Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për të gjithë praktikuesit financiarë.
- (2a) Të trajtojnë menaxherët financiarë të administratës publike në fushën e llogaridhënies menaxheriale, kontrollit të brendshëm dhe auditit të brendshëm.
- (2a) Të përditësojnë ligjin dhe manualin për Auditimin e Brendshëm, që t'i përafrojnë me standardet ndërkombëtare për auditimin e brendshëm.
- (2a) Të konsolidojnë Njësinë Qendrore të Harmonizimit në Ministrinë e Financave.
- (2b) QSH duhet të çojë përpara reformën në prokurimet elektronike, për sa i takon rritjes së transparencës dhe konkurrueshmërisë, si edhe pakësimin e kohës që duhet për të plotësuar të gjithë procedurën. Të gjitha institucionet buxhetore duhet të respektojnë këtë procedurë.

Donatorët

- (2b) Komuniteti donator i jep mbështetje QSH-së në procesin e përdorimit të metodologjisë së OECD/DAC për vlerësimin e sistemeve të prokurimit publik, nëpërmjet ndihmës teknike apo formave të tjera. Për shembull, OKB ka

ngritur një Qendër për Zhvillimin e Kapaciteteve të Prokurimit me seli në Kopenhagen (www.unpcdc.org), qëllimi i të cilës është "kapja, zhvillimi dhe përhapja e njohurive që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve të prokurimit te partnerët qeveritarë, partnerët në komunitetin e zhvillimit dhe brenda sistemit të OKB-së". Qendra synon të bëhet edhe pikë qendrore ku partnerët të gjejnë me shpejtësi informacion bashkëkohor për zhvillimin e kapaciteteve të prokurimit. Kështu, donatorët që operojnë në Shqipëri mund të konsultojnë këtë faqe interneti me qëllim që të përcaktojnë llojin dhe fushën e ndihmës që duhet të japin për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri.

- Donatorët duhet të ngrenë çdo çështje që lidhet me MFP-në dhe prokurimin publik, me qëllim që qeveria të mund të marrë masa korrigjuese.
- Të gjithë donatorët duhet të marrin pjesë në GSP-në për sistemin MFP, dhe jo vetëm donatorët që po financojnë këtë fushë.

Angazhimi donator është gjithashtu i rëndësishëm për të rritur besimin e donatorëve te MFP dhe sistemet e prokurimit të një vendi, çka çon në përdorim më të madh të këtyre sistemeve nga ana e donatorëve.

Qeveria dhe Donatorët

- (2a) Meqë Shqipëria nuk është më vend IDA, Banka Botërore nuk do ta tregojë më vlerësimin CPIA. Për këtë arsye, si qeveria ashtu edhe donatorët duhet të bashkëpunojnë që të gjejnë mënyra për të matur indikatorin 2a, në konsultim të ngushtë me OECD/DAC. Për të matur efikasitetin e mekanizmave financues, mund të përdoret sistemi PETS (Anketa e Gjurmimit të Shpenzimeve Publike) ose PEFA (Llogaridhënia për Shpenzimet Publike dhe Financat).
- (2b) QSH dhe donatorët duhet të përdorin Metodologjinë e OECD-së për Vlerësimin e Sistemeve Kombëtare të Prokurimit për të vlerësuar prokurimin publik. Kjo metodologji u mundëson vendeve të formulojnë një plan zhvillimi kapacitetesh, me qëllim që të përmirësojnë sistemin e prokurimit. Gjithashtu, kjo masë përbën detyrim që rrjedh nga Deklarata e Arushas e "Nismës së Përbashkët OECD/DAC për Prokurimin".
- (2b) Konsultimet e zhvilluara gjatë një misioni në maj 2009 të Qendrës për Zhvillimin e Kapaciteteve të Prokurimit (e OKB-së) tregojnë se aktorët kryesorë janë në favor të një vlerësimi gjithëpërfshirës që synon: (i) raportimin e indikatorëve 2b dhe 5b të Deklaratës së Parisit; (ii) identifikimin e pikave të dobëta në sistemin e prokurimit publik dhe hartimin e një plani zhvillimi kapacitetesh bazuar te ai vlerësim, dhe; (iii) marrjen e vlerësimit si bazë për diskutime në lidhje me rritjen e përdorimit të sistemeve të prokurimit në vend, siç është rënë dakord në Deklaratën e Parisit dhe në Axhendën e Akrës për Veprim.

III. Indikatori 3: Flukset e Ndhmës në përputhje me Prioritetet Kombëtare

Indikatori 3: Flukset e Ndhmës të përafuara me Prioritetet Kombëtare	
Objektivi global	Gjysma e flukseve të ndihmës për sektorin qeveritar nuk raportohen në buxhetin e qeverisë (të paktën 85% të raportohet në buxhet)
Objektivi në nivel vendi 2010	85%
Klasifikimi 2005	32%
Klasifikimi 2007	73%
Dimension	Përafrimi

1. *Përkufizim:* Përqindja e flukseve të ndihmës për sektorin e qeverisë që raportohen në buxhetin kombëtar të partnerëve.

Ky indikator vlerëson masën në të cilën flukset e ndihmës përafrohen me prioritetet kombëtare, duke përdorur masën e ndihmës të regjistruar në buxhet si prokurë..

2. *Matja e këtij indikatori*

Ky indikator mat vëllimin total të ndihmës të regjistruar në buxhetin vjetor të vendit si përqindje e lëvrimeve donatore. Donatorët u kërkohet të japin shifrat për (i) ndihmës neto për zhvillim (ODA) të lëvruar në nivel vendi, dhe (ii) ndihmës neto për zhvillim të lëvruar vetëm për sektorin e qeverisë. Nga ana tjetër, QSH-së i kërkohet përmes një pyetësori të japë shifrat e ndihmës neto për zhvillim që regjistrohet në buxhetin vjetor qoftë si (i) grante, (ii) të ardhura, ose (iii) hua të ndihmës neto⁵. Ky indikator llogaritet në bazë të ndihmës neto për zhvillim që i është lëvruar vetëm sektorit të qeverisë (jo ndihma neto totale për zhvillim në nivel vendi) dhe ndihma neto për zhvillim e regjistruar në buxhetin e qeverisë.

3. *Rezultatet e Anketës 2008*

Për një sërë arsyesh, totali i ndihmës së lëvruar nuk përputhet plotësisht me totalin e ndihmës të regjistruar në buxhetin e qeverisë. Raporti i ndihmës së lëvruar ndaj asaj të regjistruar në buxhet u rrit nga 32% në 2005, në 73% në 2007 (këto shifra bazohen përkatësisht në Anketën 2006 dhe 2008). Ky përmirësim erdhi si rezultat i koordinimit më të mirë të ndihmës donatore nga ana e DEBASKON-it, Ministrisë së Financave dhe STD. Nëse vazhdon kjo tendencë, Shqipëria mund të arrijë në 2010 objektivin që 85% e ndihmës së lëvruar të rezultojë e regjistruar në buxhet.

Rezultatet e anketës 2008 tregojnë se Shqipëria përballet me dy sfida kryesore për përafrimin e ndihmës neto për zhvillim me programet buxhetore. Së pari, disa sektorë kanë disa projekte të mëdhenj që përfshijnë disa institucione, çka e bën të vështirë gjurmimin e këtyre projekteve. Për më tepër, mbështetja për zhvillimin vendor, rural dhe rajonal zbatohet në një sërë mënyrash të ndryshme.

4. *Progresi deri më sot*

⁵ Ky është përkufizimi i përdorur nga DAC dhe është shkruar tekstualisht. Megjithatë, në rastin e Shqipërisë, ndihma neto për zhvillim rezulton vetëm si (i) grante, ose (ii) hua, jo si të ardhura.

DEBASKON ka përfunduar procesin e përditësimit 6-mujor të bankës së të dhënave të donatorëve (bankë të dhënash me akses), që pritet të japë një panoramë më të gjerë të ndihmës së huaj në vend dhe sfondin e fushave prioritareve, sektorëve, apo nënsektorëve siç tregohen te SKZHI. Banka e të dhënave me akses ka zëvendësuar mënyrën ekzistuese me tabela Excel.

Në kuadrin e Fondit Shumëpalësh të Besimit të SPI-së, pritet të projektohet një Sistem Menaxhimi i Informacionit për Ndhimën e Huaj (SMINH), i cili do të lehtësojë regjistrimin e saktë të ndihmës në sistem, duke ngushtuar ose eliminuar boshllëkun midis ndihmës së raportuar nga donatorët e asaj të regjistruar në buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, DEBASKON ka përfunduar Raportin e Parë për Menaxhimin e Ndhimës së Huaj për vitin 2008. Burimi parësor i të dhënave për këtë raport ka qenë baza e të dhënave të donatorëve e administruar nga DEBASKON (ndërsa të dhënat dytësore janë marrë nga banka e të dhënave e OECD/DAC-it, DONH, apo SKZHI).

Me miratimin e *ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*, të gjitha institucionet buxhetore tashmë përgatitin kërkesat për PBA dhe marrin fonde buxhetore mbi bazë programesh. Investimet publike janë integruar plotësisht brenda PBA-së. Vlerësimet e investimeve publike për projekte të mëdha tashmë bazohen në *Manualin e Procedurave të Investimeve Publike* si pjesë e procesit të PBA-së. Gjithnjë e më tepër financimet e ndihmës së huaj po pasqyrohen në procesin e PBA-së.

5. Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës

Për përshtatjen e ndihmës me prioritetet kombëtare, është e nevojshme që strategjitë të jenë plotësisht funksionale (shiko indikatorin 1 lart). Rekomandimet më specifike për këtë indikator janë:

Qeveria

- Krijimi dhe mirëmbajtja e rregullt e SMINH-së konsiderohet kusht vendimtar për të përmirësuar koordinimin e donatorëve. Ky sistem do t'i mundësojë DEBASKON-it të llogaritë të gjithë ndihmën e huaj, duke lehtësuar lidhjen e saj me prioritetet e SKZHI-së. Planifikohet që puna për projektimin e SMINH-së do të fillojë në tremujorin e parë të 2010. Megjithatë, vlerësohet se SMINH nuk do të jetë funksionale për periudhën afatshkurtër dhe madje as afatmesme.
- Të vihet në dispozicion *online* një bazë të dhënash e donatorëve dhe të përditësohen *online* të gjitha të dhënat që lidhen me ndihmën e huaj.
- Për të përmirësuar përafrimin, DEBASKON-i bashkë me MF duhet të forcojnë rolin e tyre si koordinatorë të një sërë procesesh që lidhin donatorët, ministritë e linjës, Thesarin, etj.
- DEBASKON-i duhet t'u dorëzojë ministrive përkatëse listën e projekteve të financuar nga ndihma e huaj, dhe kjo të përfshihet në bazën e të dhënave të donatorëve sipas udhëzimeve të buxhetit. DEBASKON-i duhet të verifikojë nëse ato janë përfshirë në buxhet. Ky hap duhet të merret urgjentisht (normalisht lista duhet dorëzuar kur ministritë fillojnë ciklin e PBA-së).

- Që në 2008, DEBASKON-i është angazhuar të përgatisë Raportet Vjetore për Menaxhimin e Ndhmës së Huaj. Këto raporte janë gjithashtu një prej mjeteve që mund të përdoren për të përmirësuar orientimin e ndihmës së huaj.
- Është e rëndësishme që ministritë e linjës të koordinojnë përpjekjet me partnerët donatorë, nëpërmjet GSP-ve të rigjallëruar.

Donatorët

- Donatorët duhet të punojnë për përgatitjen e informacioneve më të sakta në lidhje me fushat e tyre prioritare. Kjo do të ndihmonte qeverinë dhe ministritë e linjës në orientimin e nevojave të tyre. Në këtë drejtim, donatorët duhet të ndajnë më qeverinë "Kornizat Strategjike". Meqë këto dokumente janë vetëm për përdorim të brendshëm, çdo donator mund 'të përkthejë' kornizat respektive në një formë që t'i shërbejë qeverisë. Ky dokument duhet përgatitur në kohë që të integrohet në procesin e PBA-së.
- Të përmirësohet koordinimi mes donatorëve në terren dhe atyre në zyrat qendrore: Vlerësimet kanë dëshmuar që donatorët në terren janë më të informuar për prioritetet e qeverisë, prandaj *feedback*-u i tyre është i dobishëm për të përmirësuar përafrimin e ndihmës nga zyrat qendrore. Një tjetër përmirësim do të ishte që zyrat qendrore t'i delegojnë kompetenca të mjaftueshme vendimmarrëse dhe burimet e duhura zyrave të tyre në terren.
- Për të vlerësuar saktë përafrimin e ndihmës së huaj, duhet përfshirë e gjithë ndihma, edhe ajo që shkon drejtpërdrejt për OJF-të apo agjenci të tjera dhe që nuk është regjistruar në buxhetin e shtetit. Ky rekomandim vjen edhe nga Forumi i Nivelit të Lartë i Akrës për Efikasitetin e Ndhmës. Por në praktikë, realizimi i kësaj mase mund të rezultojë i vështirë për disa arsye.
- Donatorët duhet të japin informacion relevant për dhe nënlllogaritë Llogaritë Kombëtare si psh Llogaritë Kombëtare për Shëndetin dhe të garantojnë që fondet të dokumentohen si në buxhet, me zëra, në nivelin e ministrive të linjës.

Qeveria dhe Donatorët

- Qeveria dhe donatorët duhet të përdorin më shumë DONH. Si hap i parë, të dy palët mund të angazhohen që ta bëjnë DONH-në një dokument që vërtet orienton planifikimin e ndihmës së huaj.
- GSP-të duhet të përdoren si mundësi për të diskutuar çështjet e monitorimit të strategjive të ndryshme sektoriale.
- Qeveria dhe donatorët mund të angazhohen në përgatitjen dhe mbajtjen e Takimeve Protokollare Vjetore me Donatorë.
- Qeveria dhe donatorët duhet të kryejnë Vlerësime të Përbashkëta Vjetore në nivel ministrie linje.

IV. Indikatori 4: Forcimi i kapaciteteve me mbështetje të koordinuar

Indikatori 4: Forcimi i kapaciteteve me mbështetje të koordinuar	
Objektivi global	50% e flukseve të bashkëpunimit teknik të zbatohen me programe të koordinuara që janë në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit
Objektivi në nivel vendi 2010	50%
Klasifikimi 2005	28%
Klasifikimi 2007	51%
Dimensioni	Përafrimi

1. *Përkufizim:* Ky indikator mat masën e përafrimit të bashkëpunimit teknik donator në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve me objektivat dhe strategjitë e zhvillimit të vendit partner. Kjo përjasje ndihmon në forcimin e kapaciteteve të vendeve partnerë, si dhe u përgjigjet nevojave të tyre reale.

2. *Matja e këtij indikatori*

Të dhënat për këtë indikator mblidhen përmes pyetësorit të donatorëve, ku donatorëve u kërkohet të raportojnë për:

- (i) vlerën e bashkëpunimit teknik të lëvruar në vitin kalendarik 2007, dhe
- (ii) vlerën e bashkëpunimit teknik të lëvruar përmes programeve të koordinuara në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve, në vitin kalendarik 2007.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi teknik (referuar edhe si ndihmë teknike) përcaktohet si ofrimi i njohurive në formën e personelit, trajnimeve, kërkimeve dhe ndarjes së kostove. Ajo përfshin financimin nga donatorët të:

- (i) Aktiviteteve që rrisin nivelin e njohurive, aftësitë, ekspertizën apo aftësinë prodhuese të njerëzve në vendet në zhvillim; dhe
- (ii) Shërbimeve si konsulenca, mbështetja teknike apo mbështetje me ekspertizë që kontribuon në ekzekutimin e një projekti kapitali.

Donatorët janë të ftuar të shqyrtojnë të gjitha aktivitetet për zhvillimin, me qëllim që të përcaktojnë sa bashkëpunim teknik është lëvruar nëpërmjet programeve të koordinuara që përmbushin të dy kriteret më poshtë:

A kanë komunikuar autoritetet përkatëse të vendit (qeveritare ose joqeveritare) objektiva të qarta për zhvillim kapacitetesh, si pjesë e një strategjie kombëtare apo një strategjie të gjerë sektoriale? (Po/Jo).

A është bashkëpunimi teknik i përafruar me objektivat e vendit për zhvillimin e kapaciteteve? (Po/Jo).

dhe të paktën një prej kriterëve më poshtë:

A kanë autoritetet e vendit (qeveritare ose joqeveritare) kontroll mbi bashkëpunimin teknik? (Po/Jo).

Nëse mbështetja e programit të një vendi jepet nga më shumë se një donator, a ka rregulla që përfshijnë autoritetet e vendit për koordinimin e bashkëpunimit teknik të ofruar nga donatorë të ndryshëm? (Po/Jo).

3. *Rezultatet e Anketës 2008*

Anketa 2008 tregoi se Shqipëria kishte bërë progres të theksuar gjatë vitit 2007 për sa i përket klasifikimit për indikatorin 4, duke u ngjitur në 51% nga 28% në 2005. Në fakt, kjo shifër është paksa mbi objektivin e vitit 2010 prej 50% dhe shpresojmë që kjo shifër të ruajë këto nivele ose të rritet në periudhën 2009-2010.

Kjo rritje e vlerës së bashkëpunimit teknik i atribuohet kryesisht përpjekjeve të përbashkëta të donatorëve për të përmbushur nevojat për ndihmë teknike afatgjatë dhe afatmesme për zbatimin e SPI-së. Në 2006, një Program Teknik për Nevojat Imediate të SPI-së filloi nga UNDP dhe ofroi ndihmë afatshkurtër për DEBASKON-in. Përveç kësaj, FSHB i miratuar nga qeveria në dhjetor 2007 dhe i menaxhuar nga Banka Botërore, pritet të adresojë nevojat afatmesme dhe afatgjata për forcim kapacitetesh të SPI-së.

Anketa 2008 nënvizon edhe mundësinë për ta bërë FSHB-në në Shqipëri, nëse zbatohet siç duhet, një model të praktikave më të mira.

4. *Progresi deri më sot*

DONH u përgatit në 2008 dhe identifikon të gjitha fushat prioritare që kanë nevojë për ndihmë të huaj. Për herë të parë, ky dokument lidh kërkesat e QSH-së për ndihmë të huaj me prioritetet strategjike të saj.

Shembuj nga donatorë:

Zbatimi i programit Një OKB – Ofrimi si “Një” përshtatet mirë në kontekstin e përgjithshëm kombëtar të Shqipërisë dhe mbështet përafrimin e ndihmës së huaj me prioritetet kombëtare si dhe forcon planifikimin strategjik.

5. *Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës*

Donatorët dhe qeveria të vazhdojnë punën e mirë drejt përafrimit dhe koordinimit të bashkëpunimit teknik me programet dhe strategjitë për zhvillimin e vendit.

Qeveria dhe Donatorët

- Qeveria duhet të orientojë donatorët se çfarë lloj mbështetjeje nevojitet dhe ku. Nga ana tjetër, donatorët duhet të jenë të gatshëm të përafrojnë mbështetjen e tyre në një masë më të madhe.
- GSP-të mund të përdoren si forume ku qeveria dhe donatorët identifikojnë fushat për projekte/programe të përbashkëta me bashkëpunim teknik. Gjithashtu, këto grupe pune mund të përdoren për analizimin e nevojave për zhvillim kapacitetesh.

- Si qeveria edhe donatorët duhet të përdorin elementët e Ndarjes së Punës dhe të zbatojnë nismën *Fast Tracking* për Ndarjen e Punës (FTI/DoL).
- Kur hartohen PBS të reja, duhet të përcaktohet qartë që në fillim një komponent për forcimin e kapaciteteve.
- Si qeveria edhe donatorët kanë mundësinë të (ri)formësojnë vlerësimin që bëhet në kuadrin e SPI-së. Ky vlerësim që hyri fillimisht për integrimin evropian, mund të fokusohet më tepër në nevojat për ndihmë teknike dhe për forcim kapacitetesh. Kështu, termat e referencës për vlerësimin duhet të përcillen te donatorët për komente, në mënyrë që produkti përfundimtar të jetë një plan veprimi që adreson boshllëqet, përcakton kostot dhe evidenton përgjegjësitë.
- Një tjetër çështje e rëndësishme në lidhje me forcimin e kapaciteteve është edhe efikasiteti. Edhe pse janë realizuar shumë trajnime dhe programe për forcim kapacitetesh me pjesëmarrjen e qindra dhe mijëra punonjësve të administratës publike, efikasiteti dhe shkalla e vënies në praktikë e aftësive të fituara është e diskutueshme. Këtu rol luan edhe zhvendosja e punonjësve. Kjo çështje duhet të adresohet siç duhet. QSH duhet të garantojë zbatimin e rregullave dhe procedurave të Departamentit të Administratës Publike (DAP).

V. Indikatori 5: Përdorimi i Sistemeve MFP dhe të Prokurimit

Indikatori 5: Përdorimi i Sistemeve MFP dhe të Prokurimit		
Objektivi global	<i>Për donatorët</i>	<i>Për flukset e ndihmës</i>
<i>Indikatori 5a</i>	Të gjithë donatorët të përdorin sistemet MFP të vendeve partnere (me rezultat 5+); ose 90% e donatorëve të përdorin sistemet MFP të vendeve partnere (me rezultat 3.5 - 4.5)	1. Pakësim me 2/3 të përqindjes së ndihmës për sektorin publik që nuk përdor sistemet MFP të vendeve partnere (me rezultat 5+); ose 2. Pakësim me 1/3 të përqindjes së ndihmës për sektorin publik që nuk përdor sistemet MFP të vendeve partnere (me rezultat 3.5 - 4.5).
<i>Indikatori 5b</i>	Të gjithë donatorët të përdorin sistemet e prokurimit të vendeve partnere (me rezultat 5+); ose 90% e donatorëve të përdorin sistemet e prokurimit të vendeve partnere (me rezultat 3.5 - 4.5)	1. Pakësim me 2/3 të përqindjes së ndihmës për sektorin publik që nuk përdor sistemet e prokurimit të vendit partner (me rezultat 5+); ose 2. Pakësim me 1/3 të përqindjes së ndihmës për sektorin publik që nuk përdor sistemet e prokurimit të vendeve partnere (me rezultat 3.5 - 4.5).
Objektivi në nivel vendi 2010		
<i>Indikatori 5a</i>	43%	
<i>Indikatori 5b</i>	Nuk ka	
Klasifikimi 2005		
<i>Indikatori 5a</i>	14%	
<i>Indikatori 5b</i>	6%	
Klasifikimi 2007		
<i>Indikatori 5a</i>	12%	
<i>Indikatori 5b</i>	10%	
Dimensioni	Përafrimi	

1. Përkufizim:

Indikatori 5a: përqindja e donatorëve dhe e flukseve të ndihmës që përdorin sisteme menaxhimi financiar publik në vendet partnere, të cilat ose (i) aplikojnë praktika të mira të pranuarra gjerësisht, ose (b) kanë një program reformash për ta arritur këtë.

2. Matja e këtij indikatori

Indikatori 5a fokusohet në përdorimin e sistemeve MFP kur financohet sektori i qeverisë. Ai mat vëllimin e ndihmës që përdor sistemet MFP të vendit partner si përqindje e ndihmës totale dhënë sektorit të qeverisë. Donatorëve u kërkohet të japin informacion për vëllimin e ndihmës neto për zhvillim që kanë dhënë për sektorin e qeverisë duke përdorur:

- (i) procedura kombëtare për *ekzekutimin e buxhetit*
- (ii) procedura kombëtare për *raportimin financiar*
- (iii) procedura kombëtare për *auditimin*
- (iv) *të tri procedurat kombëtare*

Indikatorit 5b fokusohet në përdorimin e sistemeve kombëtare të prokurimit në momentin kur financimi i jepet sektorit të qeverisë. Ai mat vëllimin e ndihmës që përdor sistemeve kombëtare prokurimi si përqindje e ndihmës totale të dhënë për sektorin e qeverisë. Donatorëve u kërkohet të raportojnë për ndihmën neto për zhvillim që kanë lëvruar, për të cilën kanë përdorur sisteme kombëtare prokurimi. Në rastet kur donatorët përdorimin e vendit, por në të njëjtën kohë aplikojnë masa garantuese mbrojtëse, kjo raportohet si pjesë e informacionit cilësor që jepet në Raportin e Vendit.

3. *Rezultatet e Anketës 2008*

Deklarata e Parisit inkurajon donatorët të përdorin gjithnjë e më tepër sistemet e vendit, kur këto kanë cilësi të mjaftueshme. Pavarësisht renditjes mbi mesataren për sistemet MFP dhe reformave të fundit në Shqipëri, provat sasiore tregojnë që në 2005, një masë shumë të ulët ndihme neto për zhvillim përdor sistemet e qeverisë.

Anketa Bazë 2006 për Shqipërinë konfirmoi se 14% e ndihmës përdorte sistemet MFP, e marrë si mesatare e të tre komponentëve. Për prokurimet, vetëm 6% e ndihmës përdorte sistemet e vendit. Anketa 2008 tregon një rënie të lehtë të ndihmës për sektorin e qeverisë që përdor sistemin MFP, në 12%, dhe një përmirësim të lehtë në 10% për përdorimin e sistemit të prokurimit. Të dy shifrat janë shumë larg objektivit për vitin 2010. Këto shifra përputhen edhe me konstatimet e Anketës Bazë 2006 që, në nivel global, nuk ka raport të drejtë ndërmjet cilësisë së sistemeve të një vendi partner dhe përdorimit të këtyre sistemeve nga ana e donatorit.

Në Anketën 2008, arsyeja që paraqitën shumë donatorë për mospërdorimin e sistemeve të Shqipërisë, ishte transparenca dhe llogaridhënia e pamjaftueshme e këtyre sistemeve. Faktorët e tjerë të përmendur prej tyre ishte mungesa e njohjes së sistemeve shqiptare, mungesa e besimit dhe diferencat në standardet e menaxhimit. Siç përmendëm më lart, Shqipëria bëri progres të ndjeshëm në ngritjen e sistemeve të besueshme, qeveria inicioi disa reforma në MFP dhe prokurime për të rritur besimin në sistemet e saj publike, përfshi përmirësimin e legjislacionit dhe të sistemeve të auditimit të brendshëm. Shqipëria së fundmi miratoi një strategji të re ndërsektoriale për Parandalimin, Luftën kundër Korrupsionit dhe për Qeverisjen Transparence, si edhe një Strategji kundër Pastrimit të Parave. Më parë duhet të arrihen rezultate me këto nisma, para se donatorët të përdorin për të përdorur gjerësisht sistemet kombëtare MFP. Qeveria duhet të vazhdojë të përmirësojë sistemet e saj të prokurimeve dhe të MFP-së. Qeveria duhet edhe të ndërgjegjësojë dhe të familjarizojë më tepër komunitetin ndërkombëtar për këto sisteme, duke forcuar besimin dhe duke harmonizuar standardet e menaxhimit. Megjithatë, donatorët duhet të përdorin shumë më tepër sistemet kombëtare që të arrihet objektivi prej 43% i indikatorit 5a.

4. *Progresi deri më sot*

Pavarësisht arritjeve të ndjeshme brenda MFP dhe sistemit të prokurimit publik, qëndron fakti që komuniteti donator vazhdon të ngurrojë që të përdorë sistemet e Shqipërisë. Ky ngurrin vjen nga faktorët e riskut dhe kërcënimet, reale apo të perceptuara. Një nga arsyet e përmendura se pse donatorët, dhe ndonjëherë edhe vetë

qeveria, nuk preferojnë të përdorin sistemet kombëtare të prokurimit, është se këto procedura hanë shumë kohë dhe janë të komplikuar. Sipas APP-së, aktualisht, një procedurë e hapur prokurimi elektronik ndërkombëtar zgjat 45 ditë, ndërsa një procedurë e hapur prokurimi elektronik kombëtar zgjat 23 ditë.

5. *Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës*

Përdorimi i sistemeve të vendit nga ana e donatorëve, lidhet me disponibilitetin dhe cilësinë e këtyre sistemeve; megjithatë, përmbushja e këtyre dy kushteve nuk jep garanci që donatorët do t'i përdorin në të ardhmen. Për të rritur përdorimin e sistemeve të prokurimit dhe të MFP-së, rekomandohet të merren këto masa:

Programet IPA, sidomos IPA 2008, ofrojnë mbështetje të madhe për sistemin e prokurimit në Shqipëri. Kështu, përpjekjet e qeverisë dhe të donatorëve në këtë fushë duhet të përafrohen me kujdes dhe të shfrytëzojnë mundësitë që ofrohen nëpërmjet IPA-s.

Qeveria

- (5a dhe 5b) Të forcohen sistemet kombëtare të MFP-së dhe të prokurimit, që të arrijnë standarde të pranueshme dhe të përdoren me efikasitet nga donatorët.
- (5a dhe 5b) Të merren parasysh ndryshime ligjore apo rregullatore të nevojshme për realizimin e këtyre përmirësimeve.
- (5a dhe 5b) Të rritet ndërgjegjësimi i donatorëve dhe besueshmëria për disponibilitetin dhe cilësinë e këtyre sistemeve.
- (5b) Ulja e kohës për prokurimet publike mund të jetë një incentivë e mirë për donatorët që të përdorin sistemet e prokurimit të Shqipërisë.

Donatorët

- (2a dhe 2b) Të ndihmojnë qeverinë nëpërmjet ndihmës teknike që të forcojë sistemet e MFP-së dhe të prokurimit.
- (5a dhe 5b) Të përdorë më tepër sistemet e MFP-së dhe të prokurimit të Shqipërisë (siç thekson edhe Accra, sistemet MFP janë si muskujt; kur nuk i përdor, mbeten të dobët).

VI. Indikatori 6: Forcimi i kapaciteteve duke shmangur strukturat zbatuese paralele

Indikatori 6: Forcimi i kapaciteteve duke shmangur strukturat zbatuese paralele	
Objektivi global	Pakësimi me 2/3 i njësive paralele të zbatimit të projektit (NjZP)
Objektivi në nivel vendi 2010	19
klasifikimi 2005	57
Klasifikimi 2007	24
Dimensioni	Përafrimi

1. Përkufizim:

Numri i njësive paralele të zbatimit të projektit (NjZP) në një vend. Ky indikator shprehet në vlera absolute, jo si raport. Pranohet që NjZP-të paralele dhe të integruara evoluojnë vazhdimisht, kështu që qëllimi i këtij indikator është të identifikojë më mirë ku fillon njësia paralele dhe ku mbaron njësia e integruar.

3. Matja e këtij indikator

Donatorëve iu kërkua të raportojnë për numrin e NjZP-ve që kanë përdorur në vitin kalendarik 2007. Numri total i raportuar nga të gjithë donatorët mbledhet dhe jep shifrën për këtë indikator.

3. Rezultatet e Anketës 2008

Në përgjithësi, NjZP-të që janë paralele me sistemet e vendit priren të minojnë përpjekjet kombëtare për forcim kapacitetesh, shtrembërojnë rrogat dhe çorodisin llogaridhënien. Për ta bërë ndihmën më efikase, Deklarata e Parisit inkurajon donatorët që të shmangin sa më shumë krijimin e NjZP-ve paralele. Ky indikator mat progresin drejt këtij objekti duke vlerësuar stokun e NjZP-ve paralele.

Krahasuar me vlerën bazë në 2005, rezultatet e Anketës 2008 tregojnë se Shqipëria ka bërë progres të ndjeshëm drejt këtij objekti duke ulur numrin e NjZP-ve paralele të raportuara nga 57 që ishte në 2005, në 24 në 2007. Nisur nga ky progres, duket realiste që Shqipëria të arrijë objektivin 2010 për këtë indikator.

4. Progresi deri më sot

Për vitin 2008, gjithsej 27 NjZP, 24 prej të cilave të ratifikuara në Parlament, operojnë në nivel institucional qendror (2 prej tyre janë në proces mbylljeje). Banka Botërore ka numrin më të madh të NjZP-ve (4), Banka Botërore/IDA (4) dhe 5 të tjera menaxhohen nga Banka Botërore por financohen nga GEF, Kuvajti, OPEC, Luksemburgu, IDA dhe BNRZH. BERZH-BEI dhe Italia kanë 4 NjZP secila, IDB (3), Japonia (1), Spanja (1). Shumica e NjZP-ve janë ngritur për menaxhimin dhe zbatimin e projekteve që financohen nëpërmjet huave (në 87% të rasteve).

Për ministritë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve ka numrin më të madh të NjZP-ve (9); e ndjekur nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (5); Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së

Konsumatorit (4); Ministria e Ekonomisë dhe e Tregtisë (2); dhe ministrinë e tjera kanë vetëm një NjZP.

Duhet theksuar që NjZP-të e identifikuar nga DEBASKON në analizën periodike, nuk përputhen me ato të identifikuar për Anketën 2008 të DAC. Kjo ndoshta sepse përkufizimi i NjZP-së si koncept nuk është i njëjtë për të gjithë partnerët. Gjithsesi, duhet rënë dakord se çfarë është një NjZP, në mënyrë që analizat e ardhshme të bazohen në një koncept të përbashkët.

5. *Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës*

Qeveria

- Një nga arsyet e donatorëve për mbajtjen e NjZP-ve është mungesa e kapaciteteve të qeverisë për të zbatuar projekte. Kështu, qeveria duhet të vazhdojë përpjekjet dhe të punojë për forcimin e kapaciteteve të administratës që merret me zbatimin e projekteve donatore, dhe kurdo që është e nevojshme të përmirësojë kuadrin ligjor.
- Të ristrukturohen NjZP-të ekzistuese me qëllim që të marrin përsipër menaxhimin e përgjithshëm të më shumë se një projekti. Për shembull, projektet e ndryshme që i përfshin i njëjti sektor apo nënsektor, mund të grumbullohen në një NjZP.
- Të rriten kapacitetet dhe fleksibiliteti i qeverisë në rekrutimin e stafit të projekteve sipas nevojave. Me fjalë të tjera, mangësitë adresohen duke punësuar personel të përkohshëm që paguhet ndoshta me norma më të larta se ato të shtetit, kjo mund të jetë incentivë për punësimin e njerëzve të kualifikuar që punojnë brenda departamenteve/strukturave ekzistuese dhe kështu ulet mundësia për krijimin e NjZP-ve paralele.

Donatorët

- Donatorët mund të përdorin NjZP-të ekzistuese për projekte të reja; dhe jo të ngrenë NjZP të reja
- Projektet donatore mund të parashikojnë një komponent për forcimin e kapaciteteve të administratës, në mënyrë që fillimisht kapacitetet të forcohen dhe pastaj të fillojë zbatimi i projektit.

Qeveria dhe Donatorët

- Të ripërkufizohet koncepti NjZP, në mënyrë që ky koncept të kuptohet njësoj nga të gjitha palët. Kjo është e nevojshme për të rritur besueshmërinë e matjeve të këtij indikator.

VII. Indikatori 7: Ndihmë më e parashikueshme

Indikatori : Ndihmë më e parashikueshme	
Objektivi global	Të përgjysmohet masa e ndihmës që nuk lëvrohet brenda vitit fiskal për të cilin është planifikuar
Objektivi në nivel vendi 2010	74%
Klasifikimi 2005	49%
Klasifikimi 2007	29%
Dimensioni	Përafrimi

1. Përkufizim:

Përqindja e lëvrimeve të ndihmës sipas kalendarit të miratuar në kuadret njëvjeçare ose shumëvjeçare (74% e lëvrimeve sipas kalendarit dhe të regjistruara).

Kur ndihma jepet në mënyrë të parashikueshme, vendet përfituese e kanë më të lehtë të planifikojnë dhe ta përdorin me efikasitet. Ky indikator mat masën e lëvrimeve të planifikuara (sipas raportimeve të donatorëve) që janë regjistruar nga Qeveria në sistemin kontabël kombëtar si të lëvuara. Indikatori mund të shihet në dy këndvështrime të ndryshme (dhe plotësuese).

- Së pari, për të parë nëse donatorët dhe qeveria arrijnë të lëvrojnë ndihmën në afat;
- Së dyti, nëse qeveria arrin të regjistrojë plotësisht ndihmën e lëvruar. Objektivi i Deklaratës së Parisit është të mbyllë gradualisht këtë boshllëk parashikueshmërie në mënyrë që ndihma gjithnjë e më tepër: (i) të lëvrohet sipas afateve, dhe (ii) të regjistrohet e plotë në sistemet kontabël të vendit.

2. Matja e këtij indikatori

Ky indikator mat diferencën midis ndihmës së planifikuar dhe ndihmës së lëvruar me efikasitet dhe të regjistruar në sistemet kontabël të vendit. Donatorëve u kërkohet të raportojnë për totalin e ndihmës neto për zhvillim për sektorin e qeverisë të planifikuar për lëvrim në një vit të caktuar kalendarik (2007 për Anketën 2008); dhe qeverisë i kërkohet të raportojë për totalin e ndihmës neto për zhvillim që është regjistruar në sistemet kontabël të vendit për atë vit kalendarik. Raporti midis dy shifrave jep boshllëkun e parashikueshmërisë:

3. Rezultatet e Anketës 2008

Sipas Anketës 2008, raporti i lëvrimeve në afat që janë regjistruar në buxhetin shtetëror si të lëvuara është 29%, shumë larg objektivit për vitin 2010. Kjo shifër kaq e ulët është shkaktuar nga njoftimet jo në kohë nga donatorët dhe/ose regjistrimi i pasaktë i Qeverisë. Duke e krahasuar me indikatorin bazë prej 49% në vitin 2005 (e matur nga anketa), ky indikator ka shfaqur një rënie të theksuar. Nisur nga situata aktuale, duket e pamundur që të arrihet objektivi prej 74% në vitin 2010.

4. *Progresi deri më sot*

Në janar 2009, shumica e donatorëve i raportuan DEBASKON-it më në kohë se vitin paraardhës. Megjithatë, jo të gjitha raportimet u bënë sipas formatit të kërkuar nga DEBASKON-i, çka rezultoi në: (1) vonesa të konsiderueshme në përditësimin e bazës së të dhënave, (ii) informacion i paplotë, sidomos për lëvrimet e bëra në 2008.

Ndihma e dhënë në formën e huave regjistrohet me saktësi nga Ministria e Financave dhe Departamenti i Thesarit, ndërsa grantet jo gjithmonë me kaq rregullsi. Kështu, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar regjistrimit të granteve në buxhetin e Qeverisë.

5. *Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës*

Realizimi i këtij objektivi nuk është ekskluzivisht në dorën e donatorëve; është përgjegjësi e përbashkët që kërkon që donatorët dhe qeveria të punojnë bashkë dhe njëkohësisht në fronte të ndryshme.

Bazuar në Anketën 2008, boshllëku i parashikueshmërisë qëndron në 71%, çka nënkupton se si komuniteti donator ashtu edhe qeveria duhet të bëjnë përmirësime të ndjeshme.

Qeveria

- Qeveria duhet të punojë më tepër që të bëjë më të kuptueshëm regjistrimin e lëvrimeve të bëra nga donatorët.

Donatorët

- Të punohet më tepër për të rritur korrektësinë, plotësinë dhe saktësinë e raportimit dhe parashikimeve për flukset e ndihmës që hyjnë në ciklet e planifikimit, buxhetimit dhe raportimit të qeverisë. Vëllimi i ndihmës dhe koha e lëvrimit duhet të jenë më realiste. Prandaj, iu kërkuar donatorëve të dorëzojnë parashikime 3-vjeçare të vëllimit të ndihmës dhe sektorët/nësektorët që do të mbulojë. Realizimi në kohë është vendimtar për integrimin e tyre në PBA.
- Të informojnë Qeverinë për ciklet e programimit, në mënyrë që Qeveria të dijë kur të presë angazhimin e fondeve nga secili donator. Gjithashtu, donatorët duhet të njoftojnë qeverinë për misionet e programimit që në fillim të çdo viti kalendarik.
- Të pakësohet vendimmarrja *ad hoc* për sa i përket programimit.
- Çdo donator duhet t'i japë Qeverisë informacion në kohë, për fushat specifike ku donatorët shfaqin interes për ndërhyrje.
- Të përmirësohen mekanizmat e njoftimit të Qeverisë për projekte të ardhshme, si edhe për lëvrimin e projekteve ekzistues;

- Për projektet rajonale, t'i jepet më tepër informacion Qeverisë në lidhje me vlerën dhe llojin e ndihmës që i ofrohet Shqipërisë.
- Nevojitet raportim i saktë dhe në kohë (deri tani, donatorëve u është kërkuar të raportojnë dy herë në vit). Në rastin e donatorëve/projekteve që operojnë përmes një tjetër agjencie zbatimi, mund të jetë e nevojshme që donatori të koordinohet me agjencinë e zbatimit në mënyrë që të rrisë saktësinë e të dhënave..
- Të raportohet saktë për normat e lëvrimit.

Qeveria dhe Donatorët

- Të nxiten donatorët për diskutime portofoli me Qeverinë, në përgatitje për planifikimin afatgjatë.
- Të shfrytëzohen GSP-të për të diskutuar dhe analizuar boshllëqet midis lëvrimeve të planifikuara dhe të realizuara, si dhe problemet në zbatim, vonesat që lidhen me kapacitetet e Qeverisë, mungesën e raportimit, etj.
- Të rritet fusha e veprimit e GSP-ve dhe e Zyrtarëve të Lartë të Programimit (SPO) në koordinimin e politikave dhe monitorimin e aktiviteteve, përveç koordinimit të donatorëve.
- Meqë një pjesë e boshllëkut të parashikueshmërisë shkaktohet nga problemet në zbatim, të paktën projektet e mëdha duhet të kenë një komponent ndihme teknike për forcimin e kapaciteteve të Qeverisë. Për këtë kërkohet bashkëpunimi si i Qeverisë ashtu edhe i donatorëve.

VIII. Indikatori 8: Ndihma e pakushtëzuar

Indikatori 8: Ndihma e pakushtëzuar	
Objektivi global	Progres i vazhdueshëm në kohë
Objektivi në nivel vendi 2010	More than 59%
Klasifikimi 2005	82%
Klasifikimi 2007	82%
Dimensioni	Përafrimi

1. *Përkufizim:* Përqindja e ndihmës dypalëshe që nuk ka kushtëzime.

2. *Matja e këtij indikatori*

Të dhënat për indikatorin 8 merren nga raportimi i donatorëve te Pyetësi DAC në lidhje me ndihmën e pakushtëzuar. Të dhënat sigurohen nga zyrat qendrore të donatorëve dhe mbledhen në mënyrë të përqendruar në OECD/DAC.

3. *Rezultatet e Anketës 2008*

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka arritur progres të konsiderueshëm për këtë indikator, duke kaluar ndjeshëm objektivin prej 59%. Për vitin 2007, rreth 82% e ndihmës ka qenë e pakushtëzuar. Kjo rezulton më së shumti nga roli i donatorëve që operojnë në Shqipëri.

4. *Progresi deri më sot*

Nuk janë mbledhur të dhëna të 2008-ës për këtë qëllim, prandaj nuk janë regjistruar zhvillime të veçanta për këtë indikator. Megjithatë, objektivi i këtij indikatori është realizuar dhe tejkaluar dhe nuk janë raportuar arritje të mëdha

5. *Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës*

Progresi në këtë indikator është kryesisht kontribut i punës së komunitetit donator, ndërsa Qeveria ka pasur pak aktivitet. I vetmi rekomandim që mund të jepet këtu është që donatorët të vazhdojnë përpjekjet për të mos e kushtëzuar ndihmën.

IX. Indikatori 9: Përdorimi i rregullave apo procedurave të përbashkëta

Indikatori 9: Përdorimi i rregullave apo procedurave të përbashkëta	
Objektivi global	66% e fluksit të ndihmës jepet në kontekstin e përjasjeve në bazë programi.
Objektivi në nivel vendi 2010	66%
Klasifikimi 2005	5%
Klasifikimi 2007	14%
Dimensioni	Harmonizimi

1. *Përkufizim:* Përqindja e ndihmës e dhënë si përjasje me bazë programi.

Fragmentimi i donatorëve priret të rrisë kostot e transaksioneve për vendet përfituese. Deklarata e Parisit e miratoi këtë indikator në përpjekje për të rritur harmonizimin e ndihmës dhe për të ulur kostot e transaksioneve.

2. *Matja e këtij indikatori*

Ky indikator mat ndihmën neto për zhvillim që jepet në mbështetje të përjasjeve me bazë programi (PBP), si përqindje e totalit të ndihmës neto, sesa thjesht si ndihmë neto për sektorin e Qeverisë (ashtu si indikatorët e tjerë). Logjika rationale për këtë qasje me bazë më të gjerë është se PBP-të janë një mënyrë për të dhënë ndihmë zhvillimi që nuk kufizohet vetëm te sektori i Qeverisë, por jepet edhe për sektorë joqeveritarë (p.sh. dhomat e tregtisë, organizata profesionale, organizatat e shoqërisë civile, etj.).

Donatorëve iu bënë këto pyetje:

Sa ndihmë neto për zhvillim keni lëvruar në mbështetje të nismave në kuadrin e qasjeve me bazë programi për vitin kalendarik 2007? Jepni informacion për komponentët e mëposhtëm të PBP-së:

- buxheti i drejtpërdrejtë në mbështetje të PBP-ve _____
- ndihma të tjera donatore të dhëna në mbështetje të PBP-ve _____

Vetëm ndihma neto për zhvillim që përmbush 4 kriteret e mëposhtme, kualifikohet si PBP:

- a. A mbështet nga donatorët vendi pritës apo organizata që kryen udhëheqjen e programit? (Po/Jo).
- b. A përdoret vetëm një program gjithëpërfshirës dhe kuadër buxhetor? (Po/Jo).
- c. A ekziston një proces formal për koordinimin e donatorëve dhe harmonizimin e procedurave donatore për të paktën dy nga sistemet në vijim: (i) raportimin; (ii) buxhetimin; (iii) menaxhimin financiar; dhe (iv) prokurimin? (Po/Jo).
- d. A përdor mbështetja juaj për programin të paktën dy nga sistemet vendore në vijim: (i) projektin e programit; (ii) zbatimin e programit; (iii) menaxhimin financiar; dhe (iv) monitorimin dhe vlerësimin? (Po/Jo).

Kështu, donatorëve u kërkohet të analizojnë ndihmën neto për zhvillim nën dritën e këtyre 4 kritereve, në mënyrë që të përcaktojnë nëse mund të quhet PBP.

3. *Rezultatet e Anketës 2008*

Donatorët kanë përdorur një sërë mekanizmesh për të koordinuar aktivitetet e tyre, si tryezat e rumbullakëta dhe grupet sektoriale të punës, Grupi Mbështetës i SPI-së dhe Partnerët e Zhvillimit dhe Integritit (përfshi Shtetet Anëtare të KE-së). Gjithashtu, Sekretariati Teknik i Donatorëve (STD) e lehtëson më tej këtë proces koordinimi. Një nga rekomandimet kryesore të Anketës 2008 është që donatorët duhet të përdorin shumë më tepër përjasjet me bazë programi (PBP-të).

Edhe pse përmasat e ndihmës që përdornin PBP pati përmirësim të lehtë nga 5% në 2005 në 14% në 2007, indikator i vazhdon të jetë mjaft poshtë objektivit të 2010 prej 66%.

4. *Progresi deri më sot*

Një shembull i një PBP/PBS ekzistues në Shqipëri është në sektorin e arsimit (po zbatohet që në qershor 2006), financiar nga Banka Botërore dhe CEB. PBS është krijuar brenda kuadrit të Projektit për Cilësi dhe Barazi në Arsim, që është instrumenti për aplikimin e strategjisë kombëtare. Planet e ardhshme për të mbështetur këtë sektor me instrumente të tjera, këshillohen të përdorin format të ngjashëm, që është efikas për autoritet kombëtare arsimore. PBS për arsimin mund të shërbejë si model për t'u ndjekur në sektorët e tjerë.

Një tjetër shembull është Fondi i Besimit i SPI-së i menaxhuar nga Banka Botërore dhe me pjesëmarrjen e Mbretërisë së Bashkuar, Austrisë, KE-së, Italisë, Holandës, Suedisë dhe Zvicrës, i cili e bazon zbatimin në strukturat ekzistuese të Qeverisë.

Marrëveshja e Shqipërisë për Pragun e Sfidës së Mijëvjeçarit, i zbatuar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara, është një tjetër shembull i përpjekjeve donatorë në mbështetje të PBP-ve. Kjo marrëveshje po zbatohet që nga fundi i vitit 2006.

Zbatimi i *Fast-Tracking* i Ndarjes së Punës – Qëllimi i këtij instrumenti është të ndihmojë zbatimin e Kodit të Sjelljes për Ndarjen e Punës, i miratuar nga Këshilli i Ministrave të BE-së me Vendimin e majit 2007. Shqipëria dhe Maqedonia ishin dy vendet e rajonit që zgjodhën për ta zbatuar. Në Shqipëri zbatimi filloi në shkurt 2009. Italia ka rolin e lehtësuesit në këtë proces. Po bëhet punë e përbashkët mes Qeverisë/DEBASKON-it dhe përfaqësuesve të donatorëve evropianë. Hapat e ndërmarrë deri tani janë: përgatitja e një harte donatore (përfshi hartën e fluksit të ndihmës dhe një hartë donatore bazuar në strategji) dhe e një propozimi për rolet dhe përgjegjësitë e një donatori udhëheqës në kontekstin shqiptar.

Objektivi kryesor i FT/DoL është të arrijë rezultate më të mira zhvillimi nëpërmjet ndihmës më efektive. Donatorët evropianë do të bashkëpunojnë sistematikisht në terren për të rritur koherencën e ndihmës së BE-së, për të pakësuar mbivendosjet dhe kostot e transaksioneve, etj.

5. *Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës*

Qeveria

- Të rritet roli udhëheqës i ministrive të linjës në grupet sektoriale të punës, në mënyrë që të lehtësohet përdorimi më i madh i PBP/PBS-ve. GSP-të mund të

realizojnë koordinimin e përgjithshëm të aktiviteteve dhe identifikimin e fushave sektoriale ku mund të fillojë zbatimi i programeve (jo më projekte) më të gjera si edhe integrimi i PBS-ve formale në të ardhmen.

- Të eksplorohehen mënyra për përdorimet e PBP/PBS-ve, duke filluar me disa sektorë pilotë, p.sh. mjedisin apo shëndetësinë.
- Të inkurajohen donatorët (gjatë negociatave protokollare) që të fillojnë të përdorin PBP-të, PBS-të apo Mbështetjen e Buxhetit.

Donatorët

- Të dedikohen burimet gjatë programimit, për të garantuar eksplorimin e të gjitha mundësive për zgjidhjet që drejtojnë ndërhyrjet drejt qasjeve me bazë programi
- PBS për arsimin mund të shërbejë si model për t'u ndjekur në sektorët e tjerë. Donatorëve u këshillohet të përdorin format të ngjashëm.
- Të rritet vlera e ndihmës së lëvruar si mbështetje e drejtpërdrejt buxhetore që jepet për PBP-të.

Qeveria dhe Donatorët

- Deri në fund të vitit 2009, donatorët e BE-së (dhe donatorët jo të BE-së të interesuar) dhe Qeveria (DEBASKON) duhet të bien dakord për "Planin e Zbatimit për Ndarjen e Punës (DoL)"
- Si Qeveria ashtu edhe donatorët duhet të përdorin elementët e Ndarjes së Punës dhe të zbatojnë e nismës FT/DoL.

X. Indikatori 10: Inkurajimi i analizës së përbashkët

Indikatori 10: Përqindja e misioneve në terren dhe/ose puna analitike e vendit dhe shqyrtimet diagnostike të jenë të përbashkëta.	
Objektivi global	
Indikatori 10a	40% e misioneve donatore në terren të jenë të përbashkëta
Indikatori 10b	66% e punës analitike e vendit të jetë e përbashkët
Objektivi në nivel vendi 2010	
Indikatori 10a	40% e misioneve donatore në terren të jenë të përbashkëta
Indikatori 10b	66% e punës analitike e vendit të jetë e përbashkët
Klasifikimi 2005	
Indikatori 10a	9%
Indikatori 10b	22%
Klasifikimi 2007	
Indikatori 10a	33%
Indikatori 10b	34%
Dimensioni	Harmonizimi

1. Përkufizim:

Indikatori 10a: Ky indikator fokusohet vetëm në atë grup misionesh që merren nga dy apo më shumë bashkërisht, apo nga një donator në emër të një tjetri (bashkëpunim i deleguar). Në këtë këndvështrim, qëllimi i këtij indikator është që të ketë më pak misione në përgjithësi. Gjithsesi, ky indikator njeh që ka fusha kur duhet mision me vetëm një donator.

Indikatori 10b: Ky indikator mat masën e raporteve analitike të realizuara bashkërisht nga dy apo më shumë donatorë, ose nga një donator në emër të një apo më shumë donatorëve të tjerë, si përqindje e numrit total të raporteve.

2. Matja e këtij indikator

Indikatori 10a: Donatorëve u bëhen këto pyetje:

Sa misione donatore në terren ka pasur në vitin kalendarik 2007?

(për Anketën 2008):

a. numri i misioneve: _____

b. sa prej tyre ishin të koordinuara: _____

Indikatori 10b: Donatorëve u bëhen këto pyetje:

Sa punime analitike të vendit keni realizuar në vitin kalendarin 2007?

(për Anketën 2008):

a. numri i punimeve: _____

b. sa prej tyre ishin të koordinuara: _____

3. Rezultatet e Anketës 2008

Në 2005, vetëm 9% e misioneve donatore në Shqipëri ishin të përbashkëta. Anketa 2008 tregon progres të mirë në indikatorin 10a. Në 2007, 33% e misioneve donatore ishin të përbashkëta (96 nga 291 në total), çka e afron Shqipërinë me objektivin 2010

prej 40%. Në 2007, Banka Botërore mori pjesë në numrin më të madh të misioneve të përbashkëta, e ndjekur nga OKB, kryesisht në kuadrin e nismës pilot Një OKB.

Në lidhje me koordinimin e punës analitike, disa përmirësime janë evidentuar gjatë 2007, krahasuar me 2005 – rritja nga 22% në 34%. Sidoqoftë, kjo shifër është shumë larg objektivit 2010 prej 66%. Shembulli ilustrues më i mirë do të ishte PBS për arsimin, një praktikë që mund të aplikohet edhe në sektorë të tjerë. Pritet që me avancimin e SPI-së, Qeveria të angazhohet më tepër me punë analitike të përbashkët.

4. *Progresi deri më sot*

Numri total i misioneve donatore vazhdon të jetë shumë i lartë. Anketa 2008 tregon se gjatë 2007 ka pasur një total prej 290 misionesh donatore, ose të paktën 1.2 misione për ditë pune.

Edhe në 2008, numri i misioneve donatore ka vazhduar të jetë shumë i lartë (siç është theksuar në Dialogun Qeveri-Donatorë dhe në kalendarët e DEBASKON-it). Nga të njëjtat burime vihet re se numri i misioneve të përbashkëta mbetet shumë i vogël.

5. *Rekomandimet për veprime deri në fund të 2010-ës*

Qeveria

Të hartohet një kalendar për aktivitetet që lidhen me ndihmën e huaj. Ndjekja e aktivitetit kryesor për çdo donator në kuadrin e Kalendarit SPI-së, mund të ndihmojë në pakësimin e numrit total të misioneve dhe shtimin e misioneve të përbashkëta.

Donatorët

- (10a) Të ulet numri total i misioneve (rekomandim i Anketës 2008)
- (10a) Donatorët të përdorin nismën për Ndarjen e Punës për realizimin e misioneve të përbashkëta
- (10a) Të ketë koordinim me donatorët e tjerë me synimin për të shtuar misionet e përbashkëta
- (10b) Të rritet puna e përbashkët analitike

Qeveria dhe Donatorët

(10a dhe 10b) Të rritet numri i PBS-ve.

XI. Indikatori 11: Menaxhim për Rezultate

Indikatori 11: Kuadre të Orientuara drejt Rezultateve	
Objektivi global	Pakësimi me 1/3 i numrit të vendeve pa kuadre vlerësimi të performancës që janë transparente dhe të monitorueshme
Objektivi në nivel vendi 2010	B ose A
Klasifikimi 2005	D
Klasifikimi 2007	D
Dimensioni	Menaxhim për Rezultate

1. *Përkufizim:* Ky indikator mat numrin e vendeve me kuadre vlerësimi transparente dhe të monitorueshëm të performancës, për të matur progresin në dritën e: (i) strategjive kombëtare për zhvillim; dhe (ii) programeve sektoriale.

Indikatori 11 fokusohet në një komponent të menaxhimit për rezultate: ngritjen, nga vendi partner, i një sistemi vlerësues dhe monitorues bazuar në rezultate, që të ketë cilësi të lartë, të ofrojë akses për aktorët kryesorë dhe të jetë i koordinuar në nivel kombëtar.

2. *Matja e këtij indikatori*

Ky indikator matet nëpërmjet raportit të Bankës Botërore: *Strategjitë Kombëtare për Zhvillim Bazuar në rezultate: Vlerësim dhe Sfidat në Vijim*", me anë të metodologjisë LEADS që përdorej edhe për matjen e indikatorit 1.

3. *Rezultatet e Anketës 2008*

Vlerësimi i këtij indikatori për vitin 2007 tregoi të njëjtën klasifikim D për Shqipërinë si në 2005. Kjo nënkupton që vendi ende duhet të bëjë progres të qenësishëm në përmirësimin e mekanizmave monitorues për të arritur objektivat e vitit 2010 të shprehur në Deklaratën e Parisit.

Disponibiliteti, aksesimi, cilësia dhe ofrimi në kohë i informacionit zhvillues është vendimtar për progresin e këtij indikatori. INSTAT shërben si agjenci qendrore për grumbullimin e të dhënave. Sidoqoftë, cilësia dhe shpejtësia e informacionit që jep INSTAT, jo gjithmonë është i besueshëm dhe konsistent. Në këtë aspekt, INSTAT ka përfituar, prej disa vitesh tashmë, trajnime dhe mbështetje për forcim kapacitetesh nga një sërë donatorësh që operojnë në fushën e statistikave në Shqipëri.

Duhet theksuar që Shqipëria ka përmirësuar transparencën dhe shkëmbimin e informacionit zhvillues. Për shembull, janë realizuar konsultime të gjera për projekt-SKZHI-në me shoqërinë civile, qarqet akademike dhe aktorë të tjerë kryesorë. Në vetvete, SKZHI përfshin një listë të gjerë indikatorësh për secilin sektor. Donatorët po përqendrohen gjithnjë e më shumë në forcimin e kapaciteteve të Qeverisë në menaxhimin për rezultate – mbështetje për SPI-në konsiderohet si themelor për këto përpjekje.

4. Progresi deri më sot

SKZHI dhe mjaft strategji sektoriale dhe ndërsektoriale u miratuan gjatë vitit 2008, dhe disa të tjera janë ende në proces. Këto strategji kanë përcaktuar indikatorë për matjen e progresit në secilin sektor/objektiv zhvillimi. Por, disa prej këtyre indikatorëve kanë nevojë të jenë më funksionale në mënyrë që të lehtësohet monitorimi dhe vlerësimi përgjatë fazave të zbatimit të këtyre strategjive.

Raporti i Progresit 2006-2007 i SKZHI-së u publikua në dhjetor 2008. DEBASKON organizoi dy tryeza të rrumbullakëta për shoqërinë civile dhe komunitetin donator për ta diskutuar projekt raportin. Dokumenti fokusohet në progresin e arritur në indikatorët e përcaktuar në SKZHI, si edhe në hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë. Projekt Raporti i Progresit 2006-2007, para se të publikohej, iu dërgua edhe Komisioneve Parlamentare për komente dhe diskutime. Duhet progres i mëtejshëm, dhe në këtë kontekst SKZHI përmban indikatorë të qartë të nivelit të lartë për sektorët për të shënuar progresin. Raporti gjurmon progresin kundrejt 44 indikatorëve strategjikë të nivelit të lartë.

Planet e Integruara të Ministrisë (PIM) u publikuan për herë të parë në vitin 2007, ndërsa në 2009 u botuan Raportet e para Vjetore të Ministrive. Këto raporte matin rezultatet e arritura kundrejt angazhimeve të marra në Planet e Integritit të Ministrisë (MIP). PIM-et e 2009-ës përmbanin një listë indikatorësh për rezultatet kryesore: angazhimet kryesore në integrimin evropian, hartimi i legjislacionit, projektet e mëdha të investimeve publike, projektet kryesore të ndihmës së huaj, si edhe masat kundër korrupsionit.

Në 2009, Ministria e Financave filloi monitorimin 3-mujor të *output*-eve të përcaktuara në kërkesat e PBA-ve të ministrive; disa masa të monitoruara nëpërmjet PKZMSA-së tregojnë që ka një shkallë performance. Raporti i Progresit 2008 i SKZHI-së po përgatitet dhe do të publikohet në nëntor 2009.

